

☰ Menu



HOME > NEWS

Sot, në datë 8.10.2021, u zhvillua Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve për zgjedhjen e tre anëtarëve të rinj të Këshillit të Lartë Gjyqësor, nga radhët e gjyqësorit, dhe anëtarit të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës

8 October, 2021 by **KLGG** in **AKTIVITETET**

Sot, në datë 8.10.2021, u zhvillua Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve për zgjedhjen e tre anëtarëve të rinj të Këshillit të Lartë Gjyqësor, nga radhët e gjyqësorit, dhe anëtarit të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës.



Aktiviteti u hap nga Zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë, Z. Sokol Sadushi, i cili në fjalën e tij u ndal në mënyrë të veçantë tek modeli i gjyqtarit që kupton rëndësinë e funksionit dhe që i shërben arritjes së objektivit për një gjyqësor të pavarur, të paanshëm, efektiv dhe llogaridhënës. Ndër të tjera, Z. Sadushi, theksoi se pavarësia e Këshillit të Lartë Gjyqësor, do të varet nga ata kandidatët që zgjedh Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve, përderisa shumica e Këshillit rezulton të jetë shprehje e vullnetit të trupës gjyqësore.

Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve u përshëndet edhe nga Znj. Naureda Llagami, Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ajo e cilësoi prezencën e saj në këtë takim në funksion të nxitjes së trupës gjyqësore për të reflektuar mbi shqetësimet e përbashkëta, arritjet, por mbi të gjitha mbi aspiratat për të ardhmen.

Gjatë fjalës së saj, Kryetarja e KLGJ-së evidentoi rëndësinë e institucionit të votës duke nënvizuar se ato gjyqtarë që do të votohen sot, do të jenë vullneti, fytyra dhe zëri i gjithë komunitetit të gjyqtarëve për vitet e ardhshme. Ata do të jenë pjesë e vendimmarrjes së Këshillit drejt konsolidimit të mëtejshëm të standardeve të drejtësisë së re.

Znj. Llagami, e përfundoi fjalën e saj duke përcjellë për audiencën mesazhin se: “Demokracia nuk është sport për spektatorë, por për aktorë, të cilët përpiqen aktivisht si për ndryshimin e vizionit që ne kemi për veten por që dhe të tjerët kanë për ne!”

Në vijim, kandidatët gjyqtarë, për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, prezantuan shkurtimisht platformat e tyre duke njohur të gjithë pjesëmarrësit me motivimin dhe vizionin e secilit.

Në përfundim të procedurës së votimit, Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve, zgjodhi tre anëtarët e rinj të Këshillit të Lartë Gjyqësor, përfaqësues nga tre shkallët e gjyqësorit:


- Z. Klodian Kurushi, nga Gjykata e Lartë;
- Z. Ridvan Hado, nga Gjykatat e Apeleve;
- Znj. Irena Plaku, nga Gjykatat e Rretheve Gjyqësore.

Anëtar i Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, u zgjodh z. Genti Dokollari.









[Previous](#)

[Next](#)

Njoftim për shtyp, datë 11 Tetor 2021

Njoftim për shtyp, datë 7 Tetor 2021

Publikime



Njoftime për shtyp





Kalendari i eventeve

« MAY 2022 »						
M	T	W	T	F	S	S
25	26	27	28	29	30	1
2	3	4	5	6	7	8
9	10	11	12	13	14	15
16	17	18	19	20	21	22
23	24	25	26	27	28	29
30	31	1	2	3	4	5



@2020 Keshilli i Lartë Gjygjësor

